



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura IV**  
**Kuvendi**

Në mbështetje të neneve 20 dhe 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 52. të Rregullores së Kuvendit,

Duke u nisur nga konsolidimi i institucioneve të Republikës së Kosovës në fushën e rendit dhe ligjit,

Duke çmuar rolin e EULEX-it që nga viti 2008 në fushën e rendit dhe ligjit,

Duke u nisur nga vendimi i grupit ndërkombëtar të drejtësisë për përfundimin e pavarësisë së mbikëqyrur në shtator 2012,

Duke u nisur nga letra e presidentes me zonjën Eshton, e miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës,

Duke u nisur nga drejta dhe vullneti për të ushtruar përgjegjësi të plota shtetërore,

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbledhjen plenare të mbajtur më 25 korrik 2013, pas debatit parlamentar për hetimin dhe gjykimin e krimeve të luftës, roli i EULEX-it, Qeverisë së Kosovës dhe periudha e tranzicionit, nxori këtë:

**REZOLUTË**

1. Kërkohej nga Qeveria e Republikës së Kosovës që deri më 1 shtator 2013 të sjellë në Kuvend planin tranzicional drejt përfundimit të mandatit të EULEX-it, më 15 qershor 2014.
2. Kërkohej nga Qeveria e Republikës së Kosovës të propozojë planin për ngritjen dhe plotësimin e strukturave të reja që do t'i zëvendësojnë strukturat e EULEX-it.
3. Kërkohej nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të propozojë amendamentimin e ligjeve që lidhen me kompetencat e EULEX-it.
4. Kërkohej nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të hartojë ligjet dhe të ndërtojë strukturë të domosdoshme në fushën e rendit dhe ligjit, ngjashëm me vendet tjera të rajonit.

5. Kërkohej nga të gjitha institucionet kompetente që të marrin përgjegjësitë e duhura dhe t'i plotësojnë obligimet për bartje të përgjegjësisë të plota, dhe

6. Institucionet e Republikës së Kosovës do të mbeten të përkushtuara në rrugën e integriteteve evropiane duke plotësuar kërkesat që dalin nga ky proces edhe në fushën e rendit dhe ligjit.

Nr. 04-R-012

Prishtinë, më 25 korrik 2013

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës

**Jakup KRASNIQI**

**Cc:**

- Qeverisë së Republikës së Kosovës,
- Grupeve parlamentare,
- Arkivit të Kuvendit.